



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 7413 Prishtinë, Dt. 24.11.2023

RAPORT VLERËSIMI I DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

FAKULTETI	Fakulteti i shkencave matematiko-natyrore
Departamenti / Programi	Departamenti i Kimisë / Kimi fizike dhe inorganike
Titulli	"Eliminimi i Eritromocinës nga mjedisi ujorë me anë të adsorbimit në argjilë të paaktivizuar"
Kandidatja	Valentina Rudi
Mentori	Prof. Asist. Flamur Sopaj
Aprovimi i projektpropozimit në këshillin e fakultetit	Datë: 22. 11. 2023 Ref. Nr. 7376

Në bazë të kërkesës ref. nr. 318 të datës 23. 06. 2023, për vlerësimin e dorëshkrimit të punimit të diplomës master, të parashtruar nga studentja Bsc. Valentina Rudi, komisioni për vlerësim sipas vendimit të këshillit të fakultetit me ref. nr. 3018 të datës 23. 06. 2023 paraqet raportin në vijim.

Vlerësim i projekt propozimit

Ky dorëshkrim paraqet studimin e adsorbimit të Eritromocinës në argjilë të paaktivizuar, është punuar në 40 faqe dhe përmban një listë të shkurtësive të përdorura përgjat gjithë tekstit, 14 figura dhe dy tabela. Dorëshkrimi është i organizuar në tri pjesë kryesore, përkatësisht pjesa hyrëse, pjesa e përshkrimit të materialeve dhe procedurave të përdorura si dhe pjesa e rezultateve dhe diskutimi i tyre. Gjithashtu dorëshkrimi përmban një abstrakt dhe përfundimet e punimit, rezymenë në gjuhën shqipe dhe angleze, si dhe listën e referencave. Poashtu në fund të dorëshkrimit ndodhet edhe autobiografia e kandidatës.

Në pjesën e përshkrimit të bibliografisë, kandidatja paraqet një pasqyrë të kësaj të problemit të ndotjes në përgjithësi, metodat për t'iu këndërvë ndotjes dhe sfidat lidhur me eliminimin apo reduktimin e saj. Pastaj është raportuar Eritromocina si komponim, vetitë e saj dhe përdorimi. Gjithashtu është diskutuar prania e Eritromocinës në ambientin ujor dhe efektet e saj të dëmshme në mjedis dhe rreziku potencial për shëndetin e njeriut. Duke qenë se Eritromocina konsiderohet si ndotës i ujërave, janë përshkruar edhe dis metoda për eliminimin e saj nga ujërat. Meqenëse në këtë punim është përdorur adsorbimi si metodë për eliminimin e eritromocinës nga mjedisi ujor, kandidatja ka paraqitur në mënyrë mirë të organizuar dhe ka spjeguar mirë bazat e procesit të adsorbimit, të cilat më tutje në pjesën e diskutimit të rezultateve ndihmojnë në spjegimin e tyre, duke krijuar kështu një rrjedhje të natyrshme të kësaj të dorëshkrimit.

Në pjesën eksperimentale janë paraqitur të gjitha kemikaljet dhe instrumentet e përdorura gjatë punës eksperimentale. Janë përshkruar procedurat e përpunimit të argilës si adsorbent, përgatitja e elektrodës së punës dhe sistemit elektrokimik për matje.

Rezultatet dhe diskutimi ka filluar me spjegimin e mekanizmit të përfitimit të sinjalit elektrokimik,

i cili është përdorur për matje të Eritromicinës gjatë procesit të adsorbimit. Pas kësaj janë regjistruar voltamogramet e Eritromicinës për të krjuar një derjtëz kalibrimi, e cila mëtej është përdorur për matjen e përqëndrimit të Eritromicinës. Pas kësaj janë realizuar eksperimente të adsorbimit të Eritromicinës në argjilën e paaktivizuar në masa të ndryshme të saj. Prej këtyre matjeve është ndërtuar dhe analizuar izoterma e Freundlich-ut. Kjo është pasuar me matje të tjera për të studiuar efektin e përqëndrimit fillestar të Eritromicinës në efikasitetin e adsorbimit, si dhe matje për të testuar ndikimin e CaCO_3 dhe MgCO_3 si substanca konkurente në adsorbimin e Eritromicinës.

Si përfundim është nxjerr se argjila e paaktivizuar mund të përdoret si adsorbent i mirë për eliminimin e eritromicinës nga uji. Gjithashtu rritja e masës së argjilës e largon Eritromocinën në mënyrë më e efikase. Poashtu, përqëndrimet më të vogla të ndotësit të studiuar eliminohen në mënyrë më efikase. Sa i përket substancave konkurente të studiuara si adsorbent, ato nuk ndikojnë në masë të ndjeshme në procesin e adsorbimit të eritromicinës.

Propozim

Tema e punuar, bazuar në përgatitjen bibliografike, metodologjinë, procedurat eksperimentale dhe rezultatet e fituara, i përmbushë objektivat e studimit. Prandaj në bazë të të gjithë diskutimit të mësipërm komisioni vlerëson se punimi i temës me titull: **“Eliminimi i Eritromocinës nga mjedisi ujorë me anë të adsorbimit në argjilë të paaktivizuar”**, i kandidatës Valentina Rudi i plotëson kriteret për punim të masterit. Prandaj, komisioni për vlerësim të dorëshkrimit i propozon Këshillit të Departamentit të Kimisë që punimin e kandidatës Valentina Rudi ta pranoj si punim të masterit dhe kandidatës t'i mundësoj mbrojtjen publike me qëllim të arritjes së gradës Master i Shkencave të Kimisë.

Prishtinë, Dt. 24. 11. 2023

Komisioni

Prof. Dr. Fetah Podvorica

Prof. Dr. Majlinda Daci-Ajvazi

Prof. Asist. Flamur Sopaj

